

1339/  
18.03.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT TIRANË  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 398/ Prot.

Tiranë më 18.3.2026

Lënda: Verifikim Ligjshmërie.

**KËSHILLIT TË BASHKISË VORË**

Bazuar në Ligjin nr.107/2016 «Për Prefektin e Qarkut», i ndryshuar neni 16, gërma 2/a, dhe Ligjin nr. 139/2015 « Për vetëqeverisjen Vendore», i ndryshuar, Prefekti i Qarkut Tiranë, verifikoi ligjshmërinë e vendimeve nr.8, 9, 11 dhe 13, datë 27.02.2026 të Këshillit Bashkiak Vorë.

*Vendimi nr.8, datë 27.02.2026* « Mbi miratimin e buxhetit faktik 2025 »,

*Konfirmohet* referuar Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar.

*Vendimi nr.9, datë 27.02.2026* « Mbi rishikimin e buxhetit të Bashkisë Vorë për vitin 2026 »,

*Konfirmohet* referuar Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, dhe Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar;

*Vendimi nr.11, datë 27.02.2026* «Për miratimin e disa ndryshimeve të paketës fiskale për Bashkinë Vorë 2026»,


*Konfirmohet* referuar Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

*Vendimi nr.13, datë 27.02.2026* « Mbi dhënien e ndihmës financiare familjes së z. Vladimir Tafa për shkak të djegjes së banesës »,

*Konfirmohet* referuar Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 329, datë 16.05.2012 « Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore » .

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

PREFEKTI  
SHKËLQIM HAJDARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VORË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM Nr.9**

**Dt. 27.02.2026**

**MBI RISHIKIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2026**

Këshilli Bashkiak Vorë i mbledhur sot më datë 27/02/2026,

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” ku shprehet në neni 64 për kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë, shkronja “j” miraton strukturën, organikën e kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësisve e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Neni 54, Detyrat dhe kompetencat e Keshillit Bashkiak, shkronja “ç” miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Këshilli Bashkiak Vorë në mbledhjen e datës 27.02.2026 pasi analizoi dhe diskutoi në lidhje me relacionin për “*Miratimin e rishikimit të Buxhetit për Vitin 2026*”,

**V E N D O S I**

1. Të Miratojë Rishikimin e Buxhetit për Vitin 2026 sipas tabelave më poshtë; (bashkëlidhur).
2. Ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Kryetari i Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefektura.

**KRYETARE KESHILLI**

**EMIRLANDA ÇELA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VORË**  
**DREJTORIA E MENAXHIMIT FINANCIAR DHE PROGRAMEVE TË**  
**STREHIMIT**

Nr. 1221 / Prot.

Vorë, më 27.02 .2026

**RELACION**  
**MBI MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË BUXHETIT TË BASHKISË VORË PËR VITIN 2026**

Bazuar ne ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar , ligjin nr. 68/2017 "Për Financat e vetëqeverisjes vendore". Ligjin Nr.87/2025, "Për Buxhetin e vitit 2026", në zbatim të udhëzimit të ministrit të financave Nr.9, datë 20.03.2018 "Për Procedurat standarte të zbatimit të buxetit", Drejtorja e Menaxhimit Financiar dhe Programeve të Strehimit në bashkëpunim me stafin e Bashkisë i paraqet këtë relacion Këshillit të Bashkisë Vorë.

Në kuadër të Programit Buxhetortë Bashkisë Vorë për periudhën 2026-2028, është e nevojshme të miratohet një ndryshim në vendimin aktual, me qëllim reflektimin e një shtese në buxhetin e vitit 2026, në shumën 360,514,792 lekësh. Kjo shtesë përfshin fondet e pashpenzuara të mbetura nga viti 2025, të cilat nuk u realizuan për shkaqe të ndryshme të tilla si: vonesa në procedurat e prokurimit, afatet e kufizuara të shpenzimeve dhe procedurat e papërfunduara të investimeve.

Për sa më sipër, propozojmë miratimin e kësaj shtese në buxhetin e viti 2026 në shumën e sipërpërmendur. Ky material ofron një pasqyrë të detajuar mbi burimin e të ardhurave të mbartura, si dhe një propozim të qartë për shpërndarjen e tyre sipas programeve, artikujve dhe llogarive përkatëse, duke siguruar një menaxhim efikas dhe të qëndrueshëm të financave publike.

**1. Analiza e Fondeve të mbartura nga të gjitha burimet e financimit**

Nga viti 2025 Bashkia Vorë ka trashëguar fonde të cilat paraqiten në mënyrë të përmbledhur si vijon:

NR.	EMËRTIMI	Shuma lekë
1	Trasferta e pakushtëzuar	7,186,791
2	Të Ardhurat e veta nga sektori i shpenzimeve	109,081,140
3	Të Ardhurat e veta nga sektori i të ardhurave	18,840,347
4	Fonde Rindërtimi	225,406,514
	<b>TOTALI</b>	<b>360,514,792</b>

**Fonde të mbatura të detajuara sipas programeve për Fondet e Rindërtimi, transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat vendore :**

- Vlera e trasfertës së pakushtëzuar, e mbartur nga viti 2025 për t'u përdorur në vitin 2026 është me një vlerë 7.186.791 lekë. Kjo rrjedh nga fakti që disa programe nuk kanë arritur të realizohen në masën 100 % të fondeve të parashikuara.
- Të ardhurave pa përdorur nga sektori i shpenzimeve nga viti 2025 për tu përdorur në vitin në vitin 2026 është me një vlerë 109.081.140 lekë.
- Të ardhurave pa përdorur nga sektori i të ardhurave nga viti 2025 për tu përdorur në vitin në vitin 2026 është me një vlerë 18,840.347 lekë.
- Fonde për shpronësim, i mbartur nga viti 2025 për tu përdorur në vitin 2026 është me një vlerë 2,655,728 lekë.
- Fondi për Godinën e Bashkisë Vorë, i mbartur nga viti 2025 për tu përdorur në vitin 2026 arrin vlerën 62,217,758 lekë.
- Fondi për Hartimin e projekteve të rindërtimit të pallateve në Vorë, i mbetur pa u përdorur nga vitin 2025, është 187,604 lekë, dhe do të përdoret në vitin 2026.
- Granti i mbartur për Rindërtimin e banesave individuale, të cilat janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të akt-ekspertizave të thelluara e trashëguar nga viti 2025 për tu përdorur në vitin 2026 është me një vlerë 146,495,817 lekë, këto fonde janë hapur me datë 31.12.2025 dhe si pasojë nuk kanë arritur të përdoren.
- Vlera e fondit për rindërtimin e shkollës 9- vjeçare Picar, Bashkia Vorë, është me një vlerë 13,849,607 lekë mbetur pa përdorur, e mbartur nga viti 2025 për tu përdorur në vitin 2026. rindërtimi.

Për sa sipër, fondet e mbatura sipas programeve paraqiten në mënyrë të përmbledhur si vijon:

NR.	EMËRTIMI	Shuma lekë
1	Trasfertë e Pakushtëzuar	7,186,791
2	Të Ardhurat e veta nga sektori i shpenzimeve	109,081,140
3	Të Ardhurat e veta nga sektori i të ardhurave	18,840,347
4	Fond për Shpronësim	2,655,728
5	Fond për Rindërtimin e Godinës së bashkisë Vorë	62,217,758
6	Fond për Rindërtimin Hartim Projektsh Pallatet Bashkia Vore	187,604
7	Fondi për Grantet e Rindërtimit nga e para Ds5	146,495,817
8	Fondi për Rindërtimin e Shkollës 9-VjeçarePicar, Bashkia Vorë	13,849,607
	<b>TOTALI</b>	<b>360,514,792</b>

Këto fonde të cilat trazhgohen nga viti 2025 do të rialokohen pas miratimit në Këshillin e Bashkisë Vorë kryesisht për të mbuluar detyrimet e vitit 2026 sipas programeve dhe të ndara sipas llojit të shpenzime. Për sa i përket shpenzimeve për fondet e rindërtimit do të përdoren sipas programeve të hapura nga Ministria përkatëse, ndërsa fondet që trazhgohen nga trasferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat do të përdoren sipas nevojave në të gjitha programet.

### Shpërndarja e fondeve të mbartura nga viti 2025 sipas programeve buxhetore, sipas artikujve dhe llogarive buxhetore.

Shpërndarja e fondeve të mbartura nga viti 2025 është bërë duke marrë parasyshë prioritetet strategjike të Bashkisë Vorë, duke synuar mbështetjen e funksioneve administrative, investimet publike dhe nevojave të komunitetit. Fondet janë alokuar në përputhje me nevojat e sejcilit program, duke siguruar efikasitetin në përdorimin e tyre dhe duke shmangur mbivendosjet apo mungesën e burimeve për projekte të rëndësishme. Ky proces synon jo vetëm përmbushjen e detyrimeve financiare të prapambetura, por edhe vazhdimësinë e projekteve që ndikojmë drejtpërdrejt në përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Nr	PROGRAM BUXHETOR	GRUP	KAPITULL	KOD PROGRAMI	LLOGARIA EKONOMIKE	KODI PROJEKTIT	TOTALI
1	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	00	05	01110	600	9999999	34,000,000
2	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	00	05	01110	601	9999999	6,000,000
3	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	00	05	01110	602	9999999	26,111,487
4	Shërbimet e Policisë Vendore	00	05	03140	600	9999999	900,000
5	Shërbimet e Policisë Vendore	00	05	03140	601	9999999	200,000
6	Shërbimet Bujqësore,	00	05	04220	600	9999999	4,000,000
7	Shërbimet Bujqësore,	00	05	04220	601	9999999	750,000
8	Planifikimi Urban Vendor	00	05	06140	600	9999999	2,500,000
9	Planifikimi Urban Vendor	00	05	06140	601	9999999	460,000
10	Shërbimet Publike Vendore	00	05	06260	600	9999999	11,000,000
11	Shërbimet Publike Vendore	00	05	06260	601	9999999	2,000,000
12	Shërbimet Publike Vendore	00	05	06260	602	9999999	30,000,000
13	Sport dhe Argëtim	00	05	08130	604	9999999	10,000,000
14	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	00	01	01110	602	9999999	7,186,791
15	Fond për Shpronësim	00	01	06190	606	94902AG	2,655,728
16	Fond për Rindërtimin e Godinës së bashkisë Vorë	00	01	01110	231	94902AE	62,217,758
17	Fond per Rindertimin Hartim Projektesh Pallatet Bashkia Vore	00	01	06190	230	94902AI	187,604
18	Fondi për Grantet e Rindertimit nga e para Ds5	00	01	06190	606	94902AC	146,446,097
19	Fondi për Rindertimin e Shkollës 9-VjeçarePëcar, Bashkia Vorë	00	01	09120	231	94902AD	13,849,607
20	Shpenzime operative	00	06		606		49,720
	<b>SHUMA</b>						<b>360,514,792</b>

Ky relacion pasqyron nevojën për një rialokim të kujdesshëm dhe strategjik të fondeve të mbartra nga viti 2025, duke siguruar që burimet financiare të përdoren në mënyrë efektive për mbulimin e detyrimeve, zhvillimin e projekteve prioritare dhe përmirësimin e shërbimeve publike.

Shpërndarja e këtyre fondeve është në përputhje me objektivat buxhetore dhe nevojat e komunitetit, duke garantuar transparencë dhe menaxhim të qëndrueshëm të financave publike. Për këtë arsye, kërkohet miratimi i ndryshimeve të propozuara për të mundësuar një realizim të plotë dhe efektiv të programit buxhetor të Bashkisë Vorë për vitin 2025.

*Duke ju falenderuar për Mirëkuptimin.*

**PËRGJ. FINANCE**

**DREJTORI I FINANCËS**

**KRYETAR**

**Lulzime Sulaj**



**Aida DEDJA**



**Blerim SHERA**

